

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

### Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ardian DVORANI</b>	- Kryesues
<b>Arjana FULLANI</b>	- Anëtar
<b>Evelina QIRJAKO</b>	- Anëtar
<b>Andi ÇELIKU</b>	- Anëtar
<b>Medi BICI</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretarja Ermelinda Kadiu, sot me datë 24.01.2017 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative që iu përket palëve:

**PADITËS:** Herion Jashari, i përfaqësuar në gjyq me prokurë të posaçme nga Av. Blerta Kraja.

**PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Në mungesë).

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i aktit administrativ nr. 1195, datë 12.03.2013 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për Lirim nga detyra".

*Kthimi në pozicionin e mëparshëm të punës dhe pagesën për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë.*

**BAZA LIGJORE:** Neni 22 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në lidhje me nenin 20 shkronja "a" dhe nenin 8 pika 1 shkronja "a" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil".

**Komisioni i Shërbimit Civil**, me vendimin nr. 78, datë 29.04.2013 ka vendosur:

Pranimin e ankesës së ankuesit Herion Jashari.

Shfuqizimin e Aktit Administrativ nr. 1195, datë 12.03.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për lirim nga detyra", pasi ka dalë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara nga ligji.

Kthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës si Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër.

Pagimin e pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit që nga moment i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në momentin e kthimit në vendin e punës.

Të njoftohen për këtë vendim: ankuesi Herion Jashari dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

**Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 514, datë 06.03.2014 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 78, datë 29.04.2013 të Komisionit të Shërbimit Civil.

**Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve...**

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63 germa "e" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative";

**V E N D O S I**

Lënien në fuqi të vendimit nr. 514, datë 06.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

U shpall në Tiranë, me datë 24.01.2017  
Nr. 31001-03016-00-2014 Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017-443 Vendimi (4)